



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelaria Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

<b>DATË/A:</b>	02.05.2024
<b>REFERENC-Ë:</b>	23/7650/MMPHI
<b>PËR/ZA/TO:</b>	"Ndërmarrja Publike Termokos" Sh.A. Prishtinë
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar kërkesën për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga kompania e Juaj me nr.prot.: 23/7650/1/DMMU, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi për **Përfundim të procedurës administrative** të kërkesës së Kompanisë "Ndërmarrja Publike Termokos" Sh.A. Prishtinë - për projektin "Solar4Kosova" ngrohja qendrore me solar në Shkabaj, Obiliq.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure  
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Përfundim të procedurës administrative të kërkesës së kompanisë "Ndërmarrja Publike Termokos" Sh.A. Prishtinë, e cila aplikuar për projektin "Solar4Kosova" ngrohja qendrore me solar në ngastrat kadastrale Nr. P-72614055-1879-474, P-72614055-1879-472, P-72614046-00612-1 dhe P-72614046-00612-2 zonë kadastrale Shkabaj, Obiliq.**

**A r s y e t i m**

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Raportit të VNM-së dhe dokumentacionit përcjellës të Kompanisë "Ndërmarrja Publike Termokos" Sh.A. Prishtinë, e cila aplikuar për projektin "Solar4Kosova" ngrohja qendrore me solar në Shkabaj, Obiliq, është konstatuar mungon dokumentacioni si në vijim:

- Çertifikata e Regjistrimit të Biznesit, me fletat pasuese;
- Plani i Situacionit i nënshkruar dhe i vulosur nga gjeodeti i licencuar;

Faqe 2 nga 3



- Në Kopjen e Planit të sqarohet se Parcela 612-0, a është e ndarë në parcelat 612-1 dhe 612-2.
- Në Anexin 1 – të përmirësohen Hartat sizmike dhe të largohen Hartat të cilat përfshijn territorin e Serbisë, sepse Projekti përfshinë vetëm Republikën e Kosovës.

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, Neni 17, Paragrafi 2, 3 dhe 4, Kompanisë “Ndërmarrja Publike Termokos” Sh.A. Prishtinë, me datën 05.02.2024 është dërguar njoftimi për plotësim të dokumentacionit.

Dokumentet e kërkuara janë sjellë në afatin e përcaktuar ligjor.

Bazuar në të lartcekuat, MMPHI merr vendim për **Përfundimin e Procedurës Administrative** të kërkesës për paisje me Pëlqim Mjedisor për kompaninë “Ndërmarrja Publike Termokos” Sh.A. Prishtinë, e cila aplikuar për projektin “Solar4Kosova” ngrohja qendrore me solar në ngastrat kadastrale Nr. P-72614055-1879-474, P-72614055-1879-472, P-72614046-00612-1 dhe P-72614046-00612-2 zonë kadastrale Shkabaj, Obiliq.

**Shpjegim për palën:** Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 23/7650/1- ZSP/ /24 datë: 02.05.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Komunës së Obiliqit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Divizioni për komunikim me publikun
7. Arkivot të MMPHI

Izedin Bytyqi

Zëvendësuesi Sekretarit të Përgjithshëm  
të MMPHI

Faqe 3 nga 3